



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

V E N D I M

Nr.2, datë 22.2.2017

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR NDËRTIMIN E STRUKTURAVE
ANKORUESE, PORTUALE” DHE TË AUTORIZIMIT
“PËR VEPRIMTARI NDËRTIMORE NË BRIGJE”, PËR NDËRTIMIN
E PORTIT MBM, ME VENDNDODHJE NË PORTO-ROMANO,
BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 8, të nenit 4, dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 41, dhe të nenit 84, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” dhe të vendimit nr.416, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale”, dhe të autorizimit “Për veprimtari ndërtimore në brigje”, shoqërisë koncesionare “Porti MBM” (*Multi Buoy Mooring*), me objekt “Ndërtimi i Portit MBM”, mbi pasurinë nr.96, zona kadastrale 3184, me vendndodhje në Porto-Romano, Bashkia Durrës.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I
E D I R A M A

Në mungesë
ZËVENDËSKRYEMINISTRI
NIKOL PELESHI

